

Pika të Rëndësishme të Procedurës së Azilit

Çdo shtetas i një vendi të tretë ose person pa shtetësi ka të drejtë të paraqesë kërkesë për azil. Aksesimi në procedurën e azilit është i lirë dhe falas.

1. Kërkesa për Azil ose Kërkesa për Mbrojtje Ndërkombëtare

Azilkërkues ose Kërkues për Mbrojtje Ndërkombëtare

Azilkërkues ose kërkues për mbrojtje ndërkombëtare janë shtetasit e vendeve të treta ose personat pa shtetësi, të cilët kanë paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, fillestare ose të mëvonshme, kundrejt Autoriteteve kompetente. Autoritetet Greke ofrojnë dy forma të mbrojtjes ndërkombëtare: statusin e refugjatit dhe statusin e mbrojtjes plotësuese.

Statusi i refugjatit i jepet çdo personi që u detyrua të braktisë vendin e tij të prejardhjes, ose në rastin e personit pa shtetësi, vendbanimin e zakonshëm të mëparshëm dhe nuk ka mundësi ose nuk dëshiron të kthehet në atë vend sepse ka frikë të përndjekjes për shkak të racës, besimit fetar, kombësisë, bindjeve politike ose anëtarësisë në një grup të caktuar shoqëror.

Statusi i mbrojtjes plotësuese i jepet çdo personi që nuk i përmbush kriteret e mësipërme për t'u njohur si refugjat, por për të personalisht ekzistojnë arsye serioze të bazuara nga të cilat rezulton se rrezikohet të pësojë cenime të rënda në vendin e tij të origjinës ose në vendbanimin e zakonshëm të mëparshëm, veçanërisht sepse rrezikohet me dënim me vdekje ose ekzekutim, me tortura, ose me trajtim johuman, ose degradues, ose rrezikohet jeta e tij ose integriteti i tij fizik për shkak të konfliktit të armatosur ndërkombëtar, ose të brendshëm.

Ku paraqitet kërkesa

Autoritetet kompetente për të paraqitur kërkesën tuaj fillestare janë **Qendrat e Pritjes dhe Identifikimit** në ishujt *Lesbo, Chios, Samos, Kos, Leros dhe në Evros* për të gjithë ata që futen nga ato pika. Nëse nuk dorëzoni kërkesën tuaj në pikat e mësipërme në mënyrë alternative mund të dorëzoni kërkesën tuaj në **Qendrat e Pritjes dhe Identifikimit në Malakasa dhe Dhiavata**. Autoritetet kompetente për dorëzimin e kërkesave të të miturve të pashoqëruar janë **Zyrat Rajonale të Azilit dhe Njësitë e Pavarura të Azilit**.

Kërkesa dorëzohet personalisht. Nëse nuk jeni regjistruar, mund të mbyllni takim në **platformën elektronike** të Ministrisë së Migracionit dhe Azilit në mënyrë që të regjistroheni në Qendrat e Pritjes dhe Identifikimit në Malakasa dhe Dhiavata.

Nëse keni hyrë në vend pa formalitete ligjore ose qëndroni në Greqi pa formalitete ligjore do të transportoheni në një Qendër Pritjeje dhe Identifikimi dhe nëse nuk keni dokument të një autoriteti publik që vërteton shtetësinë dhe identitetin tuaj, do t'u nënshtroheni procedurave të pritjes dhe identifikimit. Do të qëndroni detyrimisht në Mjediset e Qendrës për sa kohë do të zgjasë procedura e shqyrtimit të kërkesës suaj, me kusht që kjo kohë të mos tejkalojë (25) ditët.

Totalisht, shqyrtimi i kërkesës suaj mund të zgjasë nga (20) ditë deri në (6) muaj.

Regjistrimi i kërkesës

Regjistrimi i plotë i kërkesës suaj përmban të dhënat e identitetit tuaj, vendin e origjinës suaj, emrin e babait, të nënës, të bashkëshortit/es dhe të fëmijëve tuaj, adresën e postës tuaj elektronike,

nëse ekziston, të dhënat biometrike të identifikimit, raportimin e plotë të arsyeve për të cilat kërkonti mbrojtje ndërkombëtare, adresën e vendbanimit ose të qëndrimit , gjuhën në të cilën dëshironi të shqyrtohet kërkesa juaj dhe nëse dëshironi caktimin e një përfaqësuesi të autorizuar.

Mund t'i nënshtroheni kontrollit fizik ose kontrollit të sendeve tuaja. Mund t'u nënshtroheni egzaminimeve mjekësore.

Kur të paraqisni kërkesën tuaj, do të ketë përkthyes në mënyrë që të kontribuojë në komunikimin tuaj me punonjësit kompetentë në gjuhën që ju kuptoni për informimin tuaj në lidhje me procedurën, të drejtat dhe detyrimet tuaja si kërkuar/e i mbrojtjes ndërkombëtare, si edhe për afatet e caktuara gjatë kohëzgjatjes së procedurës.

Ditën e regjistrimit tuaj, do të fotografoheni dhe do t'ju merren dhe gjurmët tuaja daktiloskopike, si edhe të anëtarëve të familjes suaj mbi (14) vjeç. Gjurmët tuaja daktiloskopike do të futen në Bazën Qendrore Europiane EURODAC, dhe në rast se keni paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare në një Shtet tjetër European, i cili zbaton **Regullorën «Dublin III»**, ka mundësi të transportoheni atje që të shqyrtohet kërkesa juaj.

Regullorja «Dublin III» përcakton se cili nga shtetet europiane që detyrohen nga kjo regullore është përgjegjës të shqyrtojë kërkesën tuaj. Kriteret që përdoren janë si vijon, sipas rendit hierarkik: a) lidhjet familjare, b) posedim i kohëve të fundit i vizës ose lejes së qëndrimit në Shtet-Anëtar dhe c) hyrje e ligjshme ose e paligjshme në Bashkimin European.

Do të duhet të dorëzoni dokumentet tuaja të udhëtimit (p.sh pasaportën) ose çdo dokument tjetër që keni në dispozicion dhe që ka lidhje me shqyrtimin e kërkesës suaj dhe me verifikimin e identitetit tuaj dhe të anëtarëve të familjes suaj.

Informacionet që do të jepni në lidhje me kërkesën tuaj janë konfidenciale. Punonjësit kanë detyrim konfidencialiteti dhe informacionet që do t'u jepni atyre gjatë kohës së shqyrtimit të kërkesës suaj, nuk do t'u njoftohen Autoriteteve të Vendit të Origjinës suaj.

Mund të komunikoni me Komisionarin e Lartë të OKB për Refugjatët ose me Organizatë që ofron mbështetje ligjore, mjekësore dhe psikologjike.

Nëse jeni viktimë torturash, përdhunimi, ose aktesh të tjera dhune serioze, duhet të informoni përkatësisht autoritetet në mënyrë që tju ndihmojnë.

Gjatë kohës së procedurës keni të drejtën të kërkonti ndihmën e një avokati ose të një këshilltari tjetër të zgjedhjes suaj (pa ndërmjetësimin e Shërbimit të Azilit). Në këtë rast duhet të autorizoni avokatin ose këshilltarin me dokument në të cilin kërkohet legalizimi i nënshkrimit tuaj në mënyrë që të mund të paraqitet gjatë zhvillimit të intervistës ose tju përfaqësojë kundrejt Shërbimit të Azilit. Pagesa dhe shpenzimet e avokatit ose të këshilltarit do të mbulohen nga ju. Si ju ashtu dhe avokatët e autorizuar ose këshilltarët tuaj keni akses në dokumentacionin që përfshihet në dosjen tuaj administrative, sipas [kërkesës](#) suaj për këtë.

Shërbimi i Azilit do t'ju caktojë datën e intervistës dhe do të merrni Kartën e Kërkuarës për Mbrojtje Ndërkombëtare e cila mund të ketë kohëzgjatje deri (1) vit. Këtë kartë duhet ta keni gjithmonë me vete. Gjatë lëshimit të kartës që ka formën e një karte do t'ju japim Numrin e Regjistrimit Tatimor (AFM) dhe numrin e përkohshëm të sigurimeve shoqërore dhe kujdesit

shëndetësor (P.A.A.Y.P.A.).

Nëse i përkisni një grupi të veçantë (vulnerabël) dhe intervista juaj e programuar është caktuar brenda pesëmbëdhjetë ditësh nga dita e dorëzimit të kërkesës suaj, Shërbimi i Azilit ju jep kohë të mjaftueshme (deri në 3 ditë) që të përgatiteni mjaftueshëm për intervistë dhe të këshilloheni me avokat ose këshilltar tjetër që t'ju ndihmojë gjatë zhvillimit të procedurës. Ju i përkisni një grupi të veçantë (vulnerabël) veçanërisht nëse jeni i mitur, i afërm i ngushtë i viktimave të anijeve të mbytura (prindër, vëllezër, motra, fëmijë, bashkëshortë), person me invaliditet, i.e. moshuar, shtatzënë, familje me një prind të vetëm me fëmijë të mitur, viktimë e trafikimit të qenieve njerëzore, person me probleme serioze shëndetësore, person me invaliditet mendor dhe psikologjik, dhe person që ka qenë subjekt i torturës, përdhunimit apo ndonjë forme tjetër të dhunës psikologjike, fizike, apo seksuale siç janë viktimat e gjymtimit gjeneral.

Mund të kërkonti që intervista dhe përkthimi të kryhen nga punonjës të gjinisë që ju dëshironi. Kërkesa në lidhje me këtë do të shqyrtohet nga Shërbimi dhe do të plotësohet nëse ekziston kjo mundësi.

Kërkesa e Mëvonshme për Mbrojtje Ndërkombëtare

Kërkesë e Mëvonshme është kërkesa për mbrojtje ndërkombëtare që paraqitet nga e para pas vendimit përfundimtar negativ nga Policia ose Shërbimi i Azilit ose Autoriteti i Apelit ose pas heqjes dorë nga kërkesa juaj e mëparshme për mbrojtje ndërkombëtare.

Autoritetet kompetente për të paraqitur kërkesë të mëvonshme dhe për të depozituar **të dhënat e reja** që rezultuan janë [Zyrat Rajonale të Azilit ose Njësitë e Pavarura të Azilit](#) që ndodhen më pranë vendbanimit tuaj. Për dorëzimin e kërkesës së mëvonshme mund të mbyllni takim në [platformën elektronike](#) të Ministrisë së Migracionit dhe Azilit.

Pas dorëzimit të kërkesës së mëvonshme **nuk** do t'ju lëshohet kartë e kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare.

Shërbimi i Azilit do të shqyrtojë të dhënat që do të depozitoni dhe do të vendosë nëse janë të reja dhe thelbësore për kërkesën për mbrojtje ndërkombëtare. Vetëm nëse do të gjykohej e pranueshme kërkesa juaj e mëvonshme do t'ju jepet karta e kërkuarit për mbrojtje ndërkombëtare dhe do të vazhdojë shqyrtimi i kërkesës suaj nga Shërbimi i Azilit.

Nëse Shërbimi refuzon kërkesën tuaj të mëvonshme mund të ushtroni apelim kundrejt **Autoritetit të Apelit** brenda afatit (5) ditor që përmendet në vendimin që ju është dorëzuar.

Nëse paraqisni kërkesë të dytë të mëvonshme, gjatë stadi të shqyrtimit të kërkesës, nuk mbroheni automatikisht nga deportimi/kthimi.

Për çdo kërkesë të dytë të mëvonshme ose për çdo kërkesë të ardhshme të mëvonshme duhet së bashku me kërkesën tuaj të dorëzoni një mandat pagesë të shumës (300eu) e cila lëshohet me procedurën e **mandatit elektronik (e-Παράβολο)**. Në rast familjeje, kërkohet depozitimi i mandatit (300eu) për çdo anëtar në veçanti.

2. Intervista e Mbrojtjes Ndërkombëtare

Intervista zhvillohet nga nëpunës kompetent i Shërbimit të Azilit, i cili zotëron kualifikimet e duhura, ditën dhe orën që ju ka caktuar Shërbimi i Azilit.

Do të duhet t'u përgjigjeni me sinqeritet të plotë pyetjeve të tij, të depozitoni vetëm ngjarje të vërteta me mënyrë të qartë dhe të mos fshihni asnjë të dhënë që lidhet me kërkesën tuaj. Nëse depozitoni ngjarje ose pretendime jo të vërteta do të ndikohet negativisht vlerësimi mbi kërkesën tuaj.

Nëpunësi i Shërbimit të Azilit do t'ju pyesë gjatë intervistës kryesisht për të dhëna që keni përmendur në kërkesën tuaj, për të dhënat e identitetit tuaj, për mënyrën si erdhët në Greqi, për arsyet që u larguat nga vendi juaj i origjinës ose nga vendi ku banoni nëse jeni person pa shtetësi, si edhe për arsyet për të cilat nuk mundeni ose nuk dëshironi të ktheheni në atë vend. Gjatë intervistës mund të shtoni edhe çdo të dhënë tjetër që ju konsideroni të domosdoshme.

Për çdo anëtar të rritur të familjes suaj zhvillohet intervistë e veçantë. Për të miturit zhvillohet intervistë personale duke pasur parasysh pjekurinë e tyre pasojat psikologjike dhe përvojat traumatike të tyre.

Në intervistë do të jetë i/e pranishëm edhe përkthyesi/ja. Përkthimi është në gjuhën që kuptoni. Përkthimi është falas.

Në intervistë mund të paraqiteni së bashku me avokat ose me tjetër këshilltar (mjek, psikolog, ose punonjës social), të cilin do të duhet ta autorizoni me shkrim në mënyrë që të ketë mundësi të jetë i pranishëm gjatë intervistës ose t'ju përfaqësojë kundrejt Shërbimit të Azilit. Pagesa dhe shpenzimet e avokatit ose të këshilltarit tjetër do të mbulohen nga ju.

Ato çka do të thoni në intervistë janë konfidenciale. Nuk do t'u njoftohen në asnjë mënyrë autoriteteve të vendit të origjinës suaj. Por ka mundësi të njoftohen në autoritete të tjera greke.

Intervista inçizohet. Punonjësi harton një tekst (procesverbal) i cili përmban të gjitha pyetjet dhe përgjigjet e intervistës. Nëse intervista nuk inçizohet do të duhet të kontrolloni përmbajtjen e procesverbalit me ndihmën e përkthyesit, të konfirmoni përmbajtjen e tij ose të kërkonti të bëhen korrigjime dhe ta nënshkruani. Keni mundësi, të merrni kopje të procesverbalit ose edhe të inçizimit të intervistës suaj pasi të keni paraqitur kërkesë. Intervista mund të realizohet dhe nëpërmjet telekonferencës.

3. Vendimi për Kërkesën për Mbrojtje Ndërkombëtare

Pas intervistës Shërbimi i Azilit do të vendosë nëse do t'ju japë statusin e refugjatit apo të mbrojtjes plotësuese apo do të refuzojë kërkesën tuaj. Nëpunësi merr vendimin për kërkesën duke marrë parasysh deklaratat tuaja gjatë intervistës suaj personale, të dhënat që keni dorëzuar për të mbështetur kërkesën tuaj, informacionet përkatëse për vendin e origjinës suaj si edhe të gjitha të dhënat që përfshihen në dosjen tuaj administrative.

Keni mundësi ndërsa shqyrtohet kërkesa suaj [të jepni dorëheqjen nga ajo](#).

Nëse kërkesa juaj për mbrojtje ndërkombëtare refuzohet do të lëshohet vendimi i kthimit tuaj.

Dokumenti i vendimit që do t'ju dërgohet shoqërohet nga një dokument tjetër që shpjegon në gjuhën që ju kuptoni me mënyrë të thjeshtë dhe të qartë, përmbajtjen dhe pasojat e vendimit.

Mund të merrni vendimin tuaj ose personalisht, ose me postë të rekomanduar për ju, ose (për avokatin tuaj), ose nëpërmjet postës elektronike (email).

Nëse kërkesa juaj refuzohet, ose ju jepet statusi i mbrojtjes plotësuese dhe ju besoni se meritoni statusin e refugjatit, keni të drejtë të ushtroni [apelim kundrejt Autoritetit të Apelimeve \(Shkalla 2\)](#). Do të duhet të dorëzoni apelimin në Zyrën Rajonale të Azilit ose në Njësinë e Pavarur të Azilit e cila lëshoi vendimin refuzues brenda afatit që përmend vendimi që ju është dorëzuar.

Nëse ju është dhënë status refugjati ose status i mbrojtjes plotësuese mund të pajiseni me

[leje qëndrimi](#) dhe [dokument udhëtimi](#) të Republikës Greke.

4. Çfarë duhet të dini për Kartën e Kërkuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare

Gjatë regjistrimit të plotë të kërkesës suaj (depozitimi) do të merrni Kartën e Kërkuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare, e cila mund të ketë kohëzgjatje nga (30) ditë deri dhe (1) vit, sipas procedurës që shqyrtohet kërkesa juaj. Karta e Kërkuesit për Mbrojtje Ndërkombëtare, lejon qëndrimin tuaj në Greqi deri në përfundimin e shqyrtimit të kërkesës suaj. Nëse merrni vendim refuzues për kërkesën tuaj karta juaj ndalon së qenuri e vlefshme.

Karta mund të lëshohet në formë karte me regjistrim elektronik dhe rinovim.

Këtë kartë duhet ta ruani në gjendje të mirë dhe ta keni gjithmonë me vete sepse vërteton që keni depozituar kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare.

Karta e kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare është titull i përkohshëm i cili ofron [të drejta dhe detyrime të përcaktuara](#) dhe **nuk është i barasvlefshëm** me [leje qëndrimi](#).

Nuk u lëshohet kartë personave që janë në arrest ose ndodhen në procedurën e Pritjes dhe Identifikimit ose personave që dorëzojnë kërkesë të mëvonshme deri sa të gjykohet pranimi i kërkesës së tyre të mëvonshme.

Përveç të dhënave personale në kartë shënohen data e lëshimit, kohëzgjatja e vlefshmërisë dhe Numri i Përkohshëm i Sigurimeve Shoqërore dhe Kujdesit Shëndetësor i të Huajit (P.A.A.Y.P.A).

Kartën origjinale duhet ta keni gjithmonë me vete dhe sidomos në çdo veprim me Shërbimin e Azilit, veçanërisht domosdoshmërisht ditën e intervistës. Fotokopjet nuk pranohen.

Nëse deri në skadimin e kartës nuk ju është dorëzuar vendimi për kërkesën tuaj duhet të rinovoni kartën.

Për rinovimin e kartës, duhet të dorëzoni kartën e vjetër.

Keni afat të rinovoni kartën tuaj deri një ditë pas datës së skadimit të saj. **Nëse nuk rinovoni kartën deri një ditë pas datës së skadimit, karta shfuqizohet dhe kërkesa juaj do të ndërpritet.**

Nëse Shërbimi i Azilit nuk mundet të rinovojë kartën tuaj për arsye teknike ose për arsye të tjera që kanë të bëjnë me funksionimin e Shërbimit, Shërbimi i Azilit do të nxjerrë njoftim në faqen e tij elektronike në mënyrë që të informohet publiku. Në këtë rast karta juaj do të rinovohet

automatikusht.

Deklarim i humbjes së kartës:

Në rast të humbjes ose vjedhjes së kartës suaj mund të kërkon lëshimin e një karte të re nga Shërbimi i Azilit.

Shërbimi i Azilit do t'ju lëshojë një vërtetim, që keni paraqitur kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare, në të cilin do të shënohet edhe numri i kartës suaj.

Me këtë vërtetim, do t'i drejtoheni Policisë Greke, ku do të paraqisni deklaratë të humbjes së kartës.

Pasi të merrni kopje të legalizuar të deklaratës së humbjes, do të duhet ta sillni në Shërbimin e Azilit dhe të depozitoni kërkesë për lëshimin e kartës së re. Nuk lëshohet kartë e re pa kaluar dy muaj.

5. Të drejtat dhe Detyrimet tuaja si Kërkues/Kërkuese për Mbrojtje Ndërkombëtare

a) Të drejtat e Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare

Si kërkues/kërkuese për Mbrojtje Ndërkombëtare në Greqi keni të drejtat si vijon:

- Të pajiseni falas me kartën e kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare e cila ju jep të drejtën e lëvizjes së ligjshme brenda vendit.
- Të qëndroni në Greqi deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj dhe ndalohej të deportoheni deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj.
- Të qarkulloni lirisht në vend, përveç se nëse në kartën e kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare që keni marrë përcaktohet një zonë e caktuar e vendit, në të cilën lejohet të qarkulloni dmth ekziston kufizim gjeografik.
- Të informoheni në gjuhën që ju kuptoni në lidhje me progresin e kërkesës suaj, për afatet në statet e ndryshme të saj, për të drejtën e apelimit dhe për vendimet për sa u përket kërkesave tuaja.
- E Drejta për përkthim falas në statet e ndryshme të kërkesës në shkallë të parë dhe të dytë dhe veçanërisht, gjatë intervistës në Shërbimin e Azilit.
- E Drejta [për kthim të vullnetshëm në vendin e origjinës](#).
- Të komunikoni me Komisariatit e Lartë të OKB për Refugjatët ose me organizatë që ofron ndihmë juridike, mjekësore dhe psikologjike.
- E Drejta për [ndihma ekonomike](#) nëse nuk punoni dhe të ardhurat tuaja ekonomike nuk mjaftojnë për të mbuluar nevojat tuaja të përditshme.
- E Drejta për strehim në Qendër Strehimi ose në vendstrehim tjetër (programe strehimi në banesa private ose në hotele).
- E Drejta për punësim me kushtet që cakton legjislacioni grek, pasi të kalojnë (60) ditë nga data e depozitimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, dhe nëse dispononi Kartë Kërkuesi për Mbrojtje Ndërkombëtare.
- E Drejta e lëshimit të [Numrit të Regjistrimit Tatimor \(AFM\)](#).
- Të drejta dhe detyrime për sigurimet shoqërore të të punësuarve njëloj sikurse edhe shtetasit/et Grekë/e.

- E Drejta e aksesit në sistemin e kujdesit mjekësor, spitalor dhe farmaceutik me lëshimin e [Numrit të Përkohshëm të Sigurimeve Shoqërore dhe Kujdesit Shëndetësor të të Huajit \(P.A.A.Y.P.A.\)](#).
- E Drejta për akses në sistemin publik arsimor pa pagesë për kërkues/kërkuese të mitur/mitura.
- E Drejta për akses në arsimimin e mesëm për kërkuesit/kërkueset e rritur/ritura.
- E Drejta për akses në kualifikimin profesional.

b) Detyrimet e Kërkuesve për Mbrojtje Ndërkombëtare

Si Kërkues për Mbrojtje Ndërkombëtare në Greqi keni detyrimet e mëposhtme:

- Të paraqisni kërkesë për mbrojtje ndërkombëtare menjëherë pas hyrjes në Greqi.
- Të keni gjithmonë me vete kartën e kërkuesit. Karta e kërkuesit për mbrojtje ndërkombëtare është titull provizor i cili ofron të drejta dhe detyrime të përcaktuara dhe nuk është i barasvlefshëm me leje qëndrimi.
- Të kujdeseni në kohën e duhur për rinovimin e kartës suaj përpara skadimit të saj, dhe jo më vonë se një ditë pas datës së skadimit.
- Të qëndroni në Greqi deri sa të përfundojë shqyrtimi i kërkesës suaj. Nuk mund të udhëtoni jashtë Greqisë-me përjashtim të kushteve të vecanta, kur rezultojnë arsye humanitare serioze, të cilat diktojnë prezencën tuaj në vend tjetër siç janë arsye të vërtetuara shëndetësore. Do të duhet të depozitoni kërkesë drejt Shërbimit në mënyrë që t'u lëshohet dokument udhëtimi.
- Të bashkëpunoni me autoritetet greke për ofrimin e informacioneve për çdo temë në lidhje me kërkesën tuaj dhe verifikimin e të dhënave të identitetit tuaj.
- Të paraqiteni pranë Shërbimit të Azilit për intervistën tuaj të programuar.
- Të paraqiteni përballë Autoriteteve kompetente, kurdoherë që të thirrreni.
- Të dorëzoni dokumentin tuaj të udhëtimit dhe të paraqisni çdo dokument tjetër që ju keni në dispozicion dhe ka lidhje me shqyrtimin e kërkesës dhe të të dhënave që verifikojnë identitetin tuaj.
- Të informoni Shërbimin e Azilit menjëherë për adresën e banimit tuaj dhe për të dhënat e komunikimit, si edhe për ndryshimin e tyre. Mund të depozitoni dhe [kërkesë elektronike për ndryshimin e të dhënave të komunikimit](#). Shërbimi i Azilit do të dërgojë në të dhënat e komunikimit tuaj (email, adresë banimi) që deklaroni, dokumente që kanë lidhje me kërkesën tuaj.
- Të paraqiteni pranë Shërbimit të Azilit për regjistrimin e fëmijëve që lindin në Greqi, pas regjistrimit të kërkesës suaj, duke dorëzuar çertifikatën e tyre të lindjes.
- Të respektoni afatet që ju caktohen nga autoritetet kompetente në statet e ndryshme të procedurës së shqyrtimit të kërkesës suaj.
- Të mos fshihni gjendjen tuaj reale ekonomike në rast se shijoni ndihma nga Shteti.
- Të zbatoni rregulloret e funksionimit në rast se qëndroni në [Qendër Pritje dhe Identifikimi, Strukturë Strehimi ose në cdo vend tjetër strehimi](#) dhe të mos i braktisni këto vende pa njoftuar autoritetet kompetente.
- Për çdo kërkesë të dytë ose të ardhme të mëvonshme, duhet së bashku me kërkesën të depozitoni mandat pagesë (300eu) e cila lëshohet me procedurën e mandatit elektronik([e-Παράβολο](#)).

Në rastin e familjes kërkohet depozitimi i kësaj shume për çdo anëtar në veçanti.

Shkelja e detyrimit të bashkëpunimit me Autoritetet kompetente, sic përcaktohet më sipër dhe veçanërisht moskomunikimi me Autoritetet dhe mosbashkëpunimi për përcaktimin e të dhënave

të cilat janë të domosdoshme për shqyrtimin e kërkesës me rezultat pengimin e përfundimit të procedurës së shqyrtimit të kërkesës për mbrojtje ndërkombëtare, sjell si pasojë refuzimin e kërkesës.

Shkelja e detyrimeve të mësipërme çon në ndërprerjen ose kufizimin e përfitimeve materiale që merrni (psh,ndihma,strehim etj.).

6. Kthim i vullnetshëm në Vendin e Origjinës

Keni të drejtën nëse dëshironi të ktheheni në vendin e origjinës, pasi të keni dhënë dorëheqjen nga procedura e azilit.

Të gjithë ju që shfaqni dëshirën për kthim të vullnetshëm, dërgoheni për informacion më të gjerë në Organizatën Ndërkombëtare për Migrim (I.O.M.), e cila merr përsipër procedurat për riatdhesimin tuaj.

Mund të gjeni më shumë informacione për programin e kthimit të vullnetshëm të I.O.M [Këtu.](#)

Së fundmi do të donim tju informojmë, që ndalohet të futen në mjediset e Shërbimeve të Azilit: armë, sende të mprehta, ose sende që mund të përdoren për të shkaktuar dëmtim, traumatizim, lëndë shpërthyes dhe të ndezshme, substanca kimike dhe toksike.